



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/08/2020

Datë: 07.05.2020

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), nenit 16 paragrafi 9 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1. të Rregullores mbi transparencën, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 30.04.2020 nxjerrë:

V E N D I M

**për hapjen e diskutimit publik për
projekt Planin Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave në Komunën e Junikut,**

- I. Me këtë vendim hapet diskutimi publik për projekt Planin Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave në Komunën e Junikut, /në tekstin e mëtejme Plani/.
- II. Projekt Plani nga pika I. e këtij vendimi vihen në dispozicion të publikut për shqyrtim publik dhe komente.
- III. Të gjitha propozimet dhe vërejtjet që paraqiten nga publiku brenda afatit kohor prej 15 ditëve do të përfshihen në raportin e shqyrtimit publik.
- IV. Ekspozimi i projekt Planit do të bëhet në zyrën për SHPIM dhe SH, të objektit të Komunës së Junikut.
- V. Diskutimi publik i projekt Planit zgjat 15 ditë (fillon më: 08.04.2020 dhe përfundon më: 24.04.2020).
- VI. Gjatë kohës së diskutimit publik projekt Plani ekspozohet edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe komente.
- VII. Diskutimi publik i projekt Planit organizohet nga Komuna e Junikut respektivisht Drejtoria për SHPM dhe SH, e Komunës së Junikut.
- VIII. Organizatori është i obliguar që të hartojë planin e veprimit dhe organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së diskutimit publik të këtij projekt Plani.
- IX. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria e SHPM dhe SH, e Komunës së Junikut.

X. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për SHPM dhe SH ;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi

